

KONKURSI NDËRKOMBËTAR I PROJEKTIMIT URBAN & ARKITEKTONIK THIRRJE E HAPUR PËR KONCEPTE

MASTER PLANI I “QYTETIT STUDENTI”:
SHTIMI I OBJEKTEVE TË REJA DHE REHABILITIMI I REZIDENCEVE EKZISTUESE
Tiranë, Shqipëri



TERMAT E REFERENCËS

Promovues

Atelier Albania, e mandatur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Zyra e Kryeministrit, po shpall nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, një konkurs ndërkombëtar të projektimit arkitektonik, për hartimin e Master Planit dhe rehabilitimin e “Rezidencës Studentore Universitare Nr. 1”, ose “Qytetit Studenti”, sikurse njihet masivisht.

Manifesto

Kjo zonë strehon shumicën e studentëve të shkollave të larta publike dhe është streha ku qëndrojnë pjesa më e madhe e asaj klase që do të ndërtojë Shqipërinë e së nesërmes. Në këtë kampus është shkruar një nga faqet më të rëndësishme të historisë moderne Shqiptare, e cila është ‘gatuar’ në mjediset e tij sot të degraduara dhe ‘të pushtuara’ nga informaliteti. Ky kampus duhet të fitojë cilësinë dhe dinjitetin që i përshtatet brezit të ardhshëm drejtues të Shqipërisë.

Konkursi ndërkombëtar shpallet me qëllim përmirësimin e ndërtimeve ekzistuese të “Qytetit Studenti”, shtimin e ndërtimeve të reja, përmirësimin e kushteve të banesës studentore dhe jetës social-kulturore në këtë kampus rezidencial, përmirësimin e hapësirave kolektive e publike të kampusit, përcaktimin e kufijve të qartë të tij dhe ndarjen përfundimisht të kampusit nga zona e ndërtimeve informale.

Përmes kësaj thirrjeje të hapur, Atelier Albania, synon të tërheqë ekipe me arkitektë, pejsazhistë dhe dezajnera. Qëllimi është që të përftohen koncepte sa më origjinale dhe vizionare për ndërhyrje të karakterit arkitektonik dhe urban për rehabilitimin e “Qytetit Studenti”, si dhe të krijohen lidhje të forta dhe miqësore me mjedisin përreth territorit të “Qytetit Studenti”. Konceptet duhet të bazohen në parimet që gjenerohen duke kuptuar veçantitë e zonës, kërkesat dhe karakteristikat e banorëve të saj, si edhe nga eksperiencat e vendeve të tjera.

Përfituesit

Konkursi për Master Planin dhe rehabilitimin e “Qytetit Studenti” buron nga nevoja për të përmirësuar gjendjen fizike dhe funksionimin e njësisë “Rezidencat Studentore Universitare nr. 1”, si edhe për të përcaktuar kufirin e saj dhe lidhjen me vendbanimet në rrethinat e “Qytetit Studenti”. Kampusi rezidencial shtetëror është një pasuri kombëtare dhe një aset që u shërben shumicës së studentëve që studiojnë në universitetet e shkollat e larta publike në Tiranë. Kushtet e tij fizike sot, nuk japin mundësi për shumëllojshmëri mënyrash akomodimi, si edhe për forma të menaxhimit të tij që do ta shndërronin në një aset vetë-financues. Sot ai është një ‘barrë’ për buxhetin e shtetit dhe ka nevojë për rikonceptim, edhe nga pikëpamja e logjikës financiare. Por rikonceptimi i formave të menaxhimit lidhet ngushtë edhe me rikonceptimin hapsinor dhe arkitektonik të “Qytetit Studenti”, si i tërë. Në fund të këtij procesi të nisur,

besojmë se “Qyteti Studenti” do të kthehet në një destinacion studentor mjaft tërheqës, i cili do t’i shërbejë në fund më shumë studentëve dhe do të jetë një model që mund të vetë-financohet.

Autoriteti Kontraktues

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është autoriteti kontraktor në këtë proces, në emër të Qeverisë Shqiptare.

Objektivi

Produkti i konkursit do të jenë Master plani i “Qytetit Studenti” dhe koncepte të projektimit arkitektonik dhe urbane për përmirësimin e objekteve, hapësirave dhe krijimin e ndërtimeve e funksioneve të reja brenda territorit të kampusit.

Konkurentëve u kërkohet të punojnë për të arritur, si më poshtë:

- Studim i hapësirave të kampusit, objekteve ekzistuese, dhe rrethinave,

- Studim i programit aktual të kampusit dhe hulumtim për rikonceptim të funksioneve dhe aktiviteteve brenda kampusit, me qëllim krijimin e një hapësire multi-funksionale dhe tërheqëse,

- Hulumtim i tipologjive të ndryshme të akomodimit brenda kampusit,

- Hulumtim i teknologjive ‘green’ dhe ‘low cost’ për ndërtimet e kampusit të “Qytetit Studenti”,

- Propozim për rehabilitimin e hapësirës së “Qytetit Studenti”, shtimin e funksioneve të reja, përmirësimin e hapësirave kolektive dhe publike,

- Propozim për shndërrimin e kampusit “Qyteti i Studentit” nga një hapësirë për “fjetore” në një kampus me gamë të plotë funksionesh për zhvillimin e një jete të pasur studentore,

- Propozim për krijimin e kufijve të rinj dhe të qartë të kampusit “Qyteti i Studentit”, kufij të cilët mund të jenë përcaktues të hapësirës studentore, por njëkohësisht edhe ndërveprues të kësaj hapësire me habitatet në rrethinat e tij.,

- Përlllogaritjen e kostove të propozimit,

- Propozim i një plan-veprimi me disa faza për rehabilitimin e kampusit “Qyteti i Studentit”.

Çdo zgjidhje duhet të tentojë kufijtë e krijimtarisë duke u përshtatur ndërkohë me kontekstin lokal dhe duke vendosur standarde të larta të projektimit.

Çdo zgjidhje duhet të përcaktojë edhe një model të zbatueshëm në territore të tjera të ngjashme në funksion dhe tipologji, të cilat nuk janë pjesë e këtij konkursi, por kanë të njëjtën urgjencë për të ofruar hapësira dhe shërbime të bazuara në cilësi.

Zona e Konkursit

Zona e konkursit përcaktohet nga pronësia e “Qytetit Studenti”, apo “Rezidencës Studentore Universitare nr.1”, e cila shtrihet në një sipërfaqe rreth 25 ha, nga të cilat 6.7 ha janë të zëna nga ndërtime informale. Master Plani i “Qytetit Studenti” duhet të studiojë dhe të propozojë edhe një qëndrim ndaj ndërtimeve informale. Master Plani mund të pranojë si të tillë gjendjen ekzistuese të infomalitetit në periferitë e “Qytetit Studenti” dhe të krijoj një komunikim programatik me këtë realitet, ose të radikalizojë qëndrimin duke propozuar pastrimin e territoreve të pushtuara të “Qytetit Studenti” dhe rialokimin e banorëve të zhvendosur në struktura të tjera të propozuara. Qëndrimi për secilin rast duhet të jetë i argumentuar.

Gjithashtu, brenda kampusit të “Qytetit Studenti”, në pjesën e fushave të sportit është parashikuar vite më parë ndërtimi i një kompleksi me fakultete të Universitetit të Tiranës.

Master Plani duhet të studiojë dhe të japë qëndrimin e tij kundrejt projektit për vendosjen e fakulteteve në zonën e mjediseve sportive të “Qytetit Studenti”. Master Plani mund të pranojë kompleksin e fakulteteve si status quo, ose ta konsiderojë territorin tabula-rasa dhe të propozojë një funksion tjetër, të hapur ose të mbyllur. Qëndrimi duhet të jetë i argumentuar.

Qëllimi

Qëllimi i konkursit është të gjenerojë ide, të cilat do të çojnë drejt një model zhvillimi të hapësirës së “Qytetit Studenti” krejtësisht ndryshe nga ai i tanishmi, një modeli për krijimin e kushteve bashkëkohore të jetesës studentore, përmirësimin e hapësirave të përbashkëta e publike të tij, si dhe drejt investimeve nëpërmjet Partneriteteve Publike-Private. Propozimi do të ndihmojë “Qytetin Studenti” të theksojë qartazi identitetin e tij, ndërsa po në të njëjtën kohë do të përmirësojë lidhjen e zonës dhe ndërlidhjen e saj me të gjithë rrethinat.

Metodologjia

Atelier Albania është një njësi e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e mandatuar për identifikimin e zgjidhjeve alternative dhe pasurimin e arkitekturës e planifikimit nëpërmjet të menduarit përtej kornizave. Në këtë kontekst ne stimulojmë dhe mbështesim pjesëmarrjen e grupeve me profesionistë ndërkombëtarë që do të punojnë së bashku me profesionistë vendas. Ne besojmë se ky bashkëpunim me bazë ekipi do të pasurojë mënyrën sesi informohet projekti me të gjitha njohuritë e nevojshme lokale dhe ekspertizën e nivelit të lartë të projektimit. Për më tepër, ne duam të eksperimentojnë një proces konkursi bashkë – krijuese, ku projektuesit dhe disa aktorë lokalë janë të përfshirë në një proces interaktiv përzgjedhës.

Formati i konkursit është eksperimental në mënyrë që të kapërcehen ato që AA beson se janë çështje të pandara të proceseve tipike të konkurseve urbane dhe të arkitekturës.

Rezultatet e Pritshme

FAZA 1: në këtë fazë të short-listimit, kandidatët paraqesin veten e tyre duke ilustruar kapacitetet e tyre, metodologjinë dhe vizionet ndaj subjektit të konkursit. Çdo dorëzim do të shqyrtohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe ekipet do të përzgjidhen bazuar në kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit të përmendura në Fazën 1.

Mes ekipeve të kualifikuara Juria do të short-listojë ekipet që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes së Fazës 1. Këto ekipe do të thirren për të punuar gjatë një faze të dytë, për një koncept që do të synojë hartimin e Masterplanit për “Qytetin Studenti”, shtimin e ndërtimeve dhe rehabilitimin urban e arkitektonik të hapësirave dhe objekteve ekzistuese brenda kampusit.

FAZA 2: në këtë fazë të Skicë Idesë, secili grup i skicë-aplikimeve do të shqyrtohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe, bazuar në kriteret të vlerësimit të Fazës 2, do të zgjidhet një ekip fitues.

Detyra e jurisë megjithatë nuk do të përfundojë me përzgjedhjen e ekipit fitues. Anëtarët vendas të jurisë si dhe anëtarët ndërkombëtarë me përvojë profesionale në Shqipëri do të bashkëpunojnë në krijimin e një fryme të vazhdueshme udhëheqëse e udhëzuese për ekipin fitues. Ekipi do të ketë rastin të takohet me anëtarët e jurisë për të diskutuar qëndrimin e tyre, zgjidhet dhe impaktin e projektit. Ekipi duhet të bjerë dakord për të qëndruar mendje-hapur në drejtim të përshtatjes së projektit me situata të mundshme kontekstuale, për të cilat ai mund të mos ketë qenë në dijeni më parë. Juria do të luajë rolin e një këshilltari për fituesin, por edhe të partnerit për klientin në mënyrë që të ndihmojë në arritjen e një projekti të mirë harmonizuar, i cili të ketë mbështetjen e aktorëve të ndryshëm dhe të premtojë një impakt të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë në zonën e ndërhyres. Takimi/et do të zhvillohen në Tiranë

Bashkimi i skuadrave vendase me të huajat

Çdo ekip ndërkombëtar stimulohet nga organizatorët për t'u lidhur në partneritet me një ekip vendas dhe çdo ekip lokal për t'u lidhur gjithashtu me një partner ndërkombëtar. Klienti beson se për të marrë projekte vizionare dhe kontekstuale ka një nevojë të qënësishme për vizionin e dikujt që nuk e njej vendin dhe njohuritë kontekstuale të dikujt që e njej mjaft mirë terrenin. Klienti beson se një bashkëpunim i tillë mund të rrisë ndikimin e propozimit dhe të përmirësojë zbatimin e projektit. Megjithatë, në thirrjen për fazën e parë, nuk është kusht përzgjedhje që ekipet të kenë një partner lokal apo ndërkombëtar.

Përshtatshmëria

Konkursi është i hapur për të gjithë profesionistët arkitektë, të cilët arrijnë të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. të jenë të regjistruar apo të njohur nga një organ zyrtar akreditimi në vendin e origjinës së aplikantit; ose
2. atje ku njohja apo regjistrimi nuk aplikohen me ligj, aplikanti të jetë anëtar i një institucioni profesional, në vendin e origjinës.

Të gjithë aplikantët duhet të japin dëshmi të vlefshmërisë së regjistrimit profesional, njohjes apo anëtarësisë, në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Secili prej ekipeve të Fazës 1 duhet të ketë në përbërje një arkitekt, arkitekt pejsazhi, artist instalator ose skulptor, ekspert menaxhimi i sipërmarrjeve të ngjashme me kompleksin residencial studentor, inxhinier të strukturave dhe preventivues. Të gjithë anëtarët e Ekipit duhet të identifikohen në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Detajimet jepen në shtojcën 6 të Dokumentit Standart të Tenderit. DST mund të përftohen elektronikisht në www.app.gov.al.

Dokumente Aplikimi

Konkurentët duhet të dorëzojnë një seri me dokumente, në mënyrë që të jenë në përshtatje me kërkesat e konkurimit për fazën e parë dhe të dytë të konkursit.

Dokumentet e Fazës 1:

- Deklarata e Përbërjes së Skuadrës,
- CV të Stafit Primar,
- Metodologjia,
- Deklarata e Vizionit

Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST

Dokumentet e Fazës 2:

- Skicë-Idea

Kriteret e Kualifikimit

Juria do t'i zgjedhë aplikantët që do të vlerësohen gjatë fazës së parë bazuar mbi këto kriteret fillestare kualifikimi:

- Qartësia dhe plotësimi i dokumenteve të kërkuara në Fazën 1
- Përbërja profesionale e skuadrës (arkitekti, pejsazhisti, artisti, inxhinieri struktural, eksperti i menaxhimit dhe preventivuesi)
- Eksperiencat e ngjashme të studios dhe stafit kyç
- Qartësia dhe efikasiteti i metodologjisë së propozuar
- Lidhja e vizionit të prezantuar me zgjidhjen e problematikave të "Qytetit Studenti"

Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST

Kriteret e Vlerësimit

Juria do të vlerësojë aplikimet e Fazës 2 bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Krijimtaria
- Faktori i lartë i zbatueshmërisë
- Lidhje dhe impakti i propozimit me kontekstin
- Raporti kosto-impakt (kosto e ulët, impakt i madh)

Produkti Final

Konkursi do të përfundojë me zgjedhjen e një ekipi. Ekipi fitues duhet të jetë një ekip i mirë-pajisur, i cili do të jetë në gjendje të angazhohet në procesin post-konkurs.

Skuadra fituese do të angazhohet në fazën tjetër, e cila konsiston në detajimin e Master Planit të "Qytetit Studenti", për propozimin fitues të konkursit. Koncepti fitues do të ketë synim përmirësimin e ndërtimeve ekzistuese të "Qytetit Studenti", shtimin e ndërtimeve të reja, përmirësimin e kushteve të banesës studentore dhe jetës social-kulturore në këtë kampus rezidencial, përmirësimin e hapësirave kolektive e publike të kampusit, përcaktimin e kufijve të qartë të tij dhe ndarjen përfundimisht të kampusit nga zona e ndërtimeve informale.

Modeli i zhvillimit që do të detajohet nga skuadra fituese do të shërbejë fillimisht si platformë për hapjen e procesit të konkurimit për një partnership publik-privat për rehabilitimin dhe menaxhimin e kampusit "Qyteti i Studentit".

Produkti i konkursit, do të shërbejë për rehabilitimin e hapësirës së "Qytetit Studenti", dhe nga ana tjetër do të shërbejë si një projekt pilot, i pajisur me një "toolbox" për të udhëhequr procese të tjera me temën sesi mund të rehabilitohen dhe menxhohen struktura të ngjashme, në territore rezidencash studentore në Tiranë apo gjetkë.

TERMAT E REFERENCËS

Procesi Post-Konkurs

Për të koordinuar më mirë punën mes skuadrës fituese dhe porositësit të projektit, organizatorët parashikojnë 1 takim mes skuadrës, klientit dhe grupeve të interesit, gjatë procesit të detajimit të Master Planit. Koncepti këtij është që aktorët të vijnë së bashku për të ndarë idetë, propozimet dhe sugjerimet e tyre, nën kujdesin e anëtarëve të Jurisë dhe institucioneve të specializuara. Ky takim do të realizohet në Tiranë.

Çmimet e Konkursit

Konkursi do të ketë një fitues, i cili do të përfitoj një çmim prej 15, 000 Euro.

Ndërkohë që 4 skuadrat e tjera të renditura në krye të klasifikimit, pas fituesit, do të vlerësohet me një çmim 3,750 Euro secila.

Skuadra fituese do të nisë negociatat e kontratës me Klientin për Kontratën Detajimit të Masterplanit.

Kontrata e detajimit të Master Planit do të ketë fondin limit në vlerën 15,000 Euro.

Platforma e Konkursit

Lloji i Konkursit:	Konkurs Projektimi me Short-Listim
Faza 1:	Thirrje e Hapur për Shprehje Interesi
Kërkesat e Fazës 1:	Deklarata e Përbërjes së Skuadrës, CV e Stafit Kryesor, Metodologjia, Deklarata e Vizionit
Avantazh:	Bashkimi i studiove vendase dhe ndërkombëtare të Arkitekturës
Vlerësimi i Jurisë:	Short-List
Faza 2:	Dorëzimi i Skicë-Idesë
Kërkesat e Fazës 2:	Skicë-Ideja
Nën-fazë e ndërmjetme:	Vizitë në terren dhe një workshop 2-ditor me aktorët vendas
Vlerësimi i Jurisë:	1 ekip fitues, i cili do të punojë për detajimin e Masterplanit
Çmimet:	5 Çmime Çmimi I: 15,000 Euro Çmimi II-V: 3,750 Euro secili

Kalendari i Konkursit 2015

Thirrje e hapur për shprehje interesi:	26 Janar
Afati Faza 1:	16 Shkurt, ora 9.00
Short-listimi:	16-17 Shkurt
Ftesë për Skicë Ide:	18 Shkurt
Përgatitja e Skicë Idesë:	18 Shkurt – 10 Prill
Workshop TIRANA:	6-7 Mars
Detyra Finale e Projektimit + Plani i hapave:	18 Shkurt – 9 Mars
Afati Faza 2:	10 Prill
Prezantimet Publike	11 Prill
Vlerësimi i Jurisë:	11 Prill
Shpalja e Fituesve:	11 Prill

PAS - KONKURS 2015

Negociatat e Kontratës

Firmosja e Kontratës për Detajimin e Master Planit:	Prill
Procesi i Hartimit të Maste Planit të Detajuar:	Prill - Maj
Takime me AA/ Jurinë dhe Grupe Interesi:	midis 11 Prill – 25 Maj
Dorëzimi i Master Planit të Detajuar:	25 Maj

INFORMACIONE PROKURIMI

Faza e shortlistimit do të kryhet nëpërmjet sistemit elektronik në ndërfaqen me adresë:
www.app.gov.al.

Dokumentet e tenderit mund të përftohen elektronikisht në po këtë ndërfaqe:
www.app.gov.al.

Konkurentët e huaj, në mënyrë që të përdorin sistemin elektronik të prokurimit, duhet të regjistrohen on-line si një operator ekonomik në ndërfaqen:
<https://www.app.gov.al/ep/Registration.aspx>.

Instruksione të mëtejshme për konkurentët ndërkombëtarë mund të merren nga manuali i përdoruesit "EPS user manual – Economic Operators", i cili mund të shkarkohet nga ndërfaqja www.app.gov.al.

INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Secili prej Termave të Referencës mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të Organizatorit të Konkursit:
<http://www.planifikimi.gov.al>

Apo, në faqet e dedikuara për këto Konkurse:
<http://competitions.planifikimi.gov.al/studentcity/>

Mund të na kontaktoni edhe në:
student.city@planifikimi.gov.al



Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësja", Nr. 57
Kutia Postare 1023, Tiranë/ Shqipëri

www.ekonomia.gov.al
info@ekonomia.gov.al

www.planifikimi.gov.al
info@planifikimi.gov.al